

Njoftim për shtyp
11 Janar 2008

Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfitimit të kontrollit të 25.4 % të aksioneve të Bankës Credins nga shoqëritë BFSE Holding dhe SIFEM

Komisioni i Konkurrencës, në mbledhjen e tij të datës 11 janar 2008, miratoi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfitimit të kontrollit në total të 25.4% të aksioneve të Bankës Credins nga shoqëritë BFSE Holding dhe SIFEM.

Në përfundim të këtij transaksioni, BFSE Holding BV do të zotërojë 22.2 % të aksioneve në bankën Credins dhe SIFEM AG do të zotërojë 3.2 %, ndërsa pjesa prej 74.6 % të aksioneve të mbetura të kapitalit aksionar të Bankës Credins Sh.A do të zotërohet nga 12 aksionerët e saj.

Ndërmarrjet pjesëmarrëse në përqendrim ushtrojnë veprimtari financiare dhe bankare në tregje të veçanta gjeografike dhe nuk kanë klientë të përbashkët. Tregu është i hapur për konkurrencë, pa barriera hyrëse dhe karakterizohet nga ndryshime të shpejta për sa i takon shtrirjes gjeografike dhe ofrimit të produkteve të reja. Tendencat pozitive në zgjerimin e tregut bankar me degë dhe agjenci ka sjellë përmirësimin në mënyrë të dukshme të mbulimit dhe rritjes së cilësisë për produktet ekzistuese dhe atyre të reja dhe kjo, më e theksuar për qytetin e Tiranës.

Për këto arsye në bazë të nenit 24, shkronja d, dhe nenit 56 pika 1 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës", Komisioni i Konkurrencës vendosi të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfitimit të kontrollit në total të 25.4% të aksioneve të Bankës Credins respektivisht nga shoqëritë BFSE Holding (22.2%) dhe SIFEM (3.2%).

Njoftimi është paraprirë nga një proces konsultimi paraprak, i cili përbën një risi të procedurave të ndjekura nga Autoriteti i Konkurrencës me qëllim rritjen e transparencës në vendimmarrje.